



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Komisioni teknik

Prot 660/3

Tiranë, 12.9.2023

**Për kalendarin e zgjedhjeve të dy anëtarëve të Kryesisë
(Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit), si dhe për
dokumentacionin e nevojshëm për konkurrim**

Komisioni teknik për përgatitjen e zgjedhjeve, i ngritur me vendimin nr. 63 datë 11.9.2023 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi; mbështetur në nenin 15 paragrafi 4 të Statutit të saj për verifikimin e plotësimin të kushteve ligjore të kandidimit; në mbledhjen e tij të datës 12 shtator 2023 cakton këtë kalendar të zgjedhjeve:

1. Deri më datën 30 shtator 2023, *pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve konkurrues, si dhe dorëzimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimit në nenin 16 të Statutit (bashkëngjitur)*. Kërkesa a propozimi për kandidim dhe dokumentacioni dorëzohen në zyrën e protokoll-arkivës dhe administrohen në sekretarinë e komisionit teknik. Lista e kandidatëve bëhet e njohur për Asamblenë brenda 3 ditësh.

2. Deri më datën 15 tetor 2023 komisioni teknik të kryejë detyrën e ngarkuar nga Asambleja për komunikimin me institucionet respektive për vlerësimin e plotësimin të kushteve ligjore nga kandidatët e regjistruar, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 138/2015 Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike (neni 3 pika 1, germa a dhe e; si dhe neni 5 pika 1); në Ligjin nr. 45/2015 Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (neni 26 pikat 1, 2 e 6 dhe neni 29 germa gj).

3. Relacioni i komisionit teknik me listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të dorëzohet e bëhet i njohur deri më datën 17.10.2023.

4. Ftohen anëtarët e Asamblesë me titullin akademik të marrin pjesë në garën e hapur për funksionin e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit.

1. Akad. Dhimitër Haxhimihali

2. Akad. Shaban Sinani

3. Akad. Valter Memisha



Tiranë, 12 shtator 2023

Neni 16

Dokumentet e kandidimit

Kandidati për Kryetar duhet të paraqesë:

1. Kërkesën për kandidim ose pranimin e propozimit për kandidim me firmat mbështetëse.
2. Një platformë personale për drejtimin e ASH-së në 4-vitet e ardhshme.
3. Curriculum Vitae të shoqëruar me aktivitetin e tij akademik, posaçërisht me listën e plotë të botimeve shkencore.
4. Formularët për verifikim të figurës dhe për dekriminalizimin.
5. Dorëheqjen nga postet e: kryetarit a anëtarit në organet drejtuese të një partie politike; të titullarit a zëvendësit të tij në institucionet kushtetuese, në rast se mban një të tillë.

Separat nga Statuti i ASHSH

